



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve  
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale**

# **STANDARDI I PROFESIONIT**

## **TEKNIK I MESËM NË BUJQËSI**

**Kodi 6130 (në LKP<sup>1</sup>):**

**Tiranë 2022**

---

<sup>1</sup> Lista Kombëtare e Profesioneve

## **Teknik i mesëm në bujqësi**

**Kodi 6130 në LKP (“Prodhues në fermat bujqësore dhe blegtorale”)**

***Ekipi hartues: Ekipi hartues i standardit të profesionit është i përbërë nga:***

Albert Kopali	Universiteti Bujqësor i Tiranës
Isuf Demirxhiu	Agronom, Specialist në Inspektoratin e Mbrojtjes së Tokës, Ministria e Bujqësisë
Bejto Karçanaj	Agronom në “Kantina Duka”
Dhurata Thanasi	Luga e Argjendtë
Flori Uka	Uka Farm
Ermal Yzeiraj	Shkolla e Mesme Bujqësore “Rakip Kryeziu”

### **Ekipi i verifikimit dhe vleftësimit**

***Vlefshmëria e standardit: 4 vjet***

***Kërkesat për hyrje:***

Disa kërkesa për hyrje në këtë profesion:

- Kërkohet përfundimi i një kualifikimi profesional të nivelit IV në KSHK<sup>2</sup>, në këtë fushë;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryen e detyrës.

***Data e miratimit:***

***Variantet e mëparshme 6130 (në LKP 2017)***

***Përshkrim i përgjithshëm i profesionit***

Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi është një profesionist polivalent, i pajisur me aftësi të specializuara në fushën e agronomisë, teknologjive të prodhimit bimor e blegtoral, zbatimit të politikave bujqësore, përfshirë legjislacionin dhe rregulloret e sektorit të bujqësisë. Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi analizon, planifikon dhe organizon aktivitete në fushën dhe në përditshmërinë e vet. Ai/Ajo siguron dhe menaxhon burimet e nevojshme njerëzore, materiale dhe financiare dhe përgatit vendin e punës për kryerjen e detyrave. Ai/Ajo mbikëqyr procesin e përgatitjes së tokës për mbjelljen e bimëve të arave, perimeve (në fushë dhe mjedise të mbrojtura), kulturave foragjere, drufrutorëve, vreshtave, ullishtave dhe agrumeve, si dhe monitoron procesin e mbjelljes së tyre duke zbatuar masat e duhura agroteknike për kryerjen e shërbimeve të ndryshme. Ai/Ajo kryen vjeljen, klasifikimin, paketimin dhe ruajtjen e produkteve të prodhimit bujqësor.

Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë së prodhimit biologjik (BIO). Ai/Ajo mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë në prodhimin blegtoral,

---

<sup>2</sup> Korniza shqiptare e Kualifikimeve

monitoron ushqyerjen dhe mbarështimin e kafshëve shtëpiake në përputhje me llojin dhe kategorinë e tyre duke siguruar higjienën e hapësirës së mbarështimit, kafshëve dhe pajisjeve.

Ai/Ajo mbikëqyr përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, pajisjeve dhe veglave të punës për punime bazë dhe plotësuese bujqësore dhe blegtorale. Ai/Ajo mbikëqyr proceset e përpunimit (të thjeshtë) fillestar të prodhimit bujqësore dhe blegtoral duke prodhuar produkte të thjeshta ushqimore nga frutat, perimet dhe qumështi. Ai/Ajo zbaton standardet teknike në fushën e prodhimit bujqësor dhe blegtoral.

Tekniku/ja i/e mesëm/me në bujqësi diskuton me kolegët, vartësit, eprorët dhe klientët duke komunikuar në mënyrë etike dhe profesionale, si dhe zbaton parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera në komunikimin me të tjerët.

Ai/Ajo zbaton bazën ligjore që i referohet veprimtarive profesionale bujqësore, kryen detyra administrative dhe tregtare, zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit dhe përmbush standardet për garantimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të kryera, si dhe përgatit dhe plotëson dokumentacionet e duhura.

Ai/ajo ngre nivelin profesional të tij/saj duke u trajnuar vazhdimisht dhe përditësuar me teknologjitë e reja në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë.

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
<p><b><u>Funksioni</u></b> <b><u>1</u></b></p> <p>Analizon, planifikon dhe organizon punën në fermë</p>	<p><b><u>Detyra 1</u></b></p> <p>Analizon detyrën e punës për qëllim planifikimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimet në fushën e bujqësisë në vend;</li> <li>• Kuadri rregullator në fushën e bujqësisë;</li> <li>• Rëndësia e menaxhimit, planifikimit, organizimit dhe monitorimit të aktivitetit bujqësor;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e përgjegjshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të analizojë në kohë dhe me cilësi detyrën për organizimin dhe planifikimin e punës.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 2</u></b></p> <p>Planifikon veprimtarinë mujore, javore, ditore bazuar në tregues dhe rezultate konkrete</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e menaxhimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrekt/e</li> <li>• I/e përpiktë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të planifikojë veprimtarinë ditore, javore dhe mujore, bazuar në tregues dhe rezultate konkrete.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 3</u></b></p> <p>Planifikon ndërhyrjet përmirësuese në prodhimin bimor dhe blegtoral</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e teknologjive të prodhimit bujqësor;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunues/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të planifikojë në kohën e duhur ndërhyrjet përmirësuese në prodhimin bimor dhe blegtoral.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 4</u></b></p> <p>Konsultohet me eprorin për detyrën</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e mjeteve dhe pajisjeve të punës, funksioni dhe përdorimi i tyre;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e saktë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të konsultohet periodikisht me eprorin për detyrën.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 5</u></b></p> <p>Përcakton prioritetet e ditës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Preventivi i një punimi, elementët përbërës dhe llogaritjet përkatëse;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcaktojë prioritetet e ditës sipas teknologjisë së kultivimit dhe nevojave.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 6</u></b></p> <p>Planifikon burimet e nevojshme materiale, financiare dhe njerëzore</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Radha e punës dhe respektimi i fazave teknologjike të prodhimit bujqësor dhe blegtoral;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e komunikueshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të planifikojë burimet e nevojshme materiale, financiare dhe njerëzore sipas planit periodik.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 7</u></b></p> <p>Organizon në mënyrë ergonomike vendin e punës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e sistemit të vendit të punës;</li> <li>• Manualet e përdorimit të mjeteve të punës;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e dëgjueshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të organizojë në mënyrë ergonomike vendin e punës.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 8</u></b></p> <p>Ndan detyrat e punës në fermë</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e materialeve, karakteristikat e tyre dhe përdorimet përkatëse;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e shkathët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ndajë detyrat në fermë sipas sektorëve dhe përvojës së punës së burimeve njerëzore.</li> </ul>
	<p><b><u>Detyra 9</u></b></p> <p>Përcakton radhën e kryerjes së detyrave</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyra e organizimit të</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e duruar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përcaktojë radhën e kryerjes së</li> </ul>

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
	<p align="center"><b><u>Detyra 10</u></b> Koordinon punën më të tjerët</p> <p align="center"><b><u>Detyra 11</u></b> Raporton për ecurinë e punës</p>	<p>vendit të punës në mënyrë ergonomike;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontrolli teknik për gatishmërinë e mjeteve për punë;</li> <li>• Llojet dhe format e raportimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijues/e</li> <li>• Këmbëngu lës/e</li> <li>• Largpamë s/e</li> </ul>	<p>detyrave sipas teknologjisë së kultivimit.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të koordinojë periodikisht, punën me të tjerët.</li> <li>• Të raportojë periodikisht për ecurinë e punës.</li> </ul>
<p><b><u>Funksioni</u></b> <b><u>2</u></b> Përgatit vendin e punës</p>	<p align="center"><b><u>Detyra 1</u></b> Kryen përgatitje personale për punë (uniforma, higjiena personale etj.)</p> <p align="center"><b><u>Detyra 2</u></b> Përzgjedh dhe përgatit bazën materiale për fillimin e punës</p> <p align="center"><b><u>Detyra 3</u></b> Përzgjedh mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës</p> <p align="center"><b><u>Detyra 4</u></b> Përgatit vendin e punës sipas proceseve të planifikuara</p> <p align="center"><b><u>Detyra 5</u></b> Kontrollon funksionalitetin teknik të mjeteve, veglave, pajisjeve dhe makinerive të punës</p> <p align="center"><b><u>Detyra 6</u></b> Pastron vendin dhe mjetet e punës pas çdo procesi të punës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e zbatimit të rregullave mbi higjienën personale dhe pajisjeve mbrojtëse në punë;</li> <li>• Llojet e pajisjeve, veglave dhe mjeteve të punës, përdorimi dhe sigurimi i funksionalitetit teknik të tyre;</li> <li>• Llojet e materialeve të punës dhe përdorimet e tyre;</li> <li>• Llojet e solucionave pastruese, funksioni dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e kontrollit të funksionalitetit teknik të mjeteve, veglave, pajisjeve dhe makinerive;</li> <li>• Ndarja dhe grumbullimi i materialeve dhe mjeteve sipas procesit të punës;</li> <li>• Rëndësia e pastrimit paraprak të vendit të punës;</li> <li>• Kushtet e sigurisë në punë dhe mbrojtjes</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrekt/e</li> <li>• I/e sinqertë</li> <li>• Bashkëpunues/e</li> <li>• Kreativ/e</li> <li>• I/e komunikueshëm/me</li> <li>• I/e duruar</li> <li>• Fleksibël/e</li> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> <li>• Vigjilent/e</li> <li>• I/e qëndrueshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kryejë përgatitjet e duhura personale për punë në përputhje me rregulloret e higjienës dhe të sigurimit teknik.</li> <li>• Të përzgjedhë dhe përgatitë bazën materiale për fillimin e punës sipas proceseve dhe planifikimeve të punës.</li> <li>• Të përzgjedhë mjetet, veglat, pajisjet dhe makineritë e punës sipas proceseve dhe planifikimeve të punës.</li> <li>• Të përgatit vendin e punës sipas proceseve të planifikuara.</li> <li>• Të kontrollojë funksionalitetin teknik të mjeteve, veglave, pajisjeve dhe makinerive të punës sipas manualeve përkatëse.</li> <li>• Të pastrojë vendin dhe mjetet e punës pas çdo procesi të punës.</li> </ul>

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
	<p align="center"><b><u>Detyra 7</u></b></p> <p>Kontrollon kushtet e punës në përputhje me rregullat e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë</p>	së shëndetit.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e moralshë m/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kontrollojë kushtet e punës në përputhje me rregullat e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë.</li> </ul>
<p align="center"><b><u>Funksioni</u></b></p> <p align="center"><b><u>3</u></b></p> <p>Mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë së prodhimit bimor</p>	<p align="center"><b><u>Detyra 1</u></b></p> <p>Merr instruksionet për punën</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e tokave dhe karakteristikat e tyre;</li> <li>• Mënyrat e marrjes së mostrave të tokës dhe teknikat e mostrimit;</li> <li>• Mjetet e punës për marrjen e mostrave, funksioni dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• Llojet e analizave fizike e kimike të tokës dhe mënyra e interpretimit të tyre;</li> <li>• Llojet e punimeve të tokës (bazë dhe plotësuese);</li> <li>• Llojet e punimeve të tokës për kulturat njëvjeçare dhe shumëvjeçare,</li> <li>• Mjetet e punës për punimin e tokës, funksioni dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• Mënyrat dhe teknikat që përdoren për mbrojtjen e tokës;</li> <li>• Llojet e plehrave dhe mënyrat e përdorimit të tyre në plehërimin bazë dhe plotësuese;</li> <li>• Llojet e farave të bimëve, karakteristikat dhe kërkesat për fara cilësore;</li> <li>• Fidanishtet dhe teknologjitë e prodhimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrekt/e</li> <li>• I/e sinqertë</li> <li>• Bashkëpunues/e</li> <li>• I/e komunikueshëm/me</li> <li>• I/e duruar</li> <li>• Fleksibël/e</li> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> <li>• Vigjilent/e</li> <li>• I/e qëndrueshëm/me</li> <li>• Krijues/e</li> <li>• Këmbëngulës/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të marrë instruksionet për punën.</li> <li>• Të marrë mostrat e tokës për analiza agropedologjike dhe agrokimike sipas teknikave përkatëse.</li> <li>• Të mbikëqyrë përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore njëvjeçare (bimët e arave, perimet dhe kulturat foragjere) sipas teknikave dhe llojit të kulturave.</li> <li>• Të mbikëqyrë përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore shumëvjeçare (drufrutorë, vreshta, ullishte, agrume) sipas teknikave dhe llojit të kulturave.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e plehërimit bazë të tokës sipas kulturave të ndryshme bujqësore.</li> <li>• Të mbikëqyrë cilësinë e farave dhe fidanëve sipas standardeve përkatëse.</li> <li>• Të zbatojë procedurat e duhura për mbrojtjen e tokës sipas teknikave</li> </ul>
	<p align="center"><b><u>Detyra 2</u></b></p> <p>Merr mostrat e tokës për analiza agropedologjike dhe agrokimike</p>			
	<p align="center"><b><u>Detyra 3</u></b></p> <p>Mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore njëvjeçare (bimët e arave, perimet dhe kulturat foragjere)</p>			
	<p align="center"><b><u>Detyra 4</u></b></p> <p>Mbikëqyr përgatitjen e tokës për mbjelljen e kulturave bujqësore shumëvjeçare (drufrutorë, vreshta, ullishte, agrume)</p>			
	<p align="center"><b><u>Detyra 5</u></b></p> <p>Zbaton metodat e plehërimit bazë të tokës sipas kulturave të ndryshme bujqësore</p>			
	<p align="center"><b><u>Detyra 6</u></b></p> <p>Mbikëqyr cilësinë e farave dhe fidanëve</p>			

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
	<b><u>Detyra 7</u></b> Zbaton procedurat e duhura për mbrojtjen e tokës	të fidanëve; • Skemat e thjeshta dhe të përbëra të qarkullimit bujqësor dhe rëndësia e zbatimit të tyre,		përkatëse. • Të zbatojë sistemin e qarkullimit bujqësor të bimëve sipas teknologjive përkatëse.
	<b><u>Detyra 8</u></b> Zbaton skemat e qarkullimit bujqësor të bimëve	• Mënyrat e mbjelljes dhe normat e farave të bimëve të ndryshme;		• Të mbikëqyrë procesin e mbjelljes me farë sipas teknologjive përkatëse.
	<b><u>Detyra 9</u></b> Mbikëqyr procesin e mbjelljes me farë	• Teknikat e mbjelljes së fidanëve (në fushë dhe mjedise të mbrojtura);		• Të mbikëqyrë procesin e mbjelljes me fidanë në fushë dhe mjedise të mbrojtura sipas teknologjive përkatëse.
	<b><u>Detyra 10</u></b> Mbikëqyr procesin e mbjelljes së fidanëve në fushë dhe mjedise të mbrojtura	• Llojet e shërbimeve agroteknike; • Sistemet e ujitjes së bimëve; • Mënyrat dhe normat e plehërimit plotësues të bimëve;		• Të mbikëqyrë procesin e ujitjes së bimëve sipas teknologjisë së kulturave.
	<b><u>Detyra 11</u></b> Mbikëqyr procesin e ujitjes së bimëve	• Mënyrat dhe koha e punimeve plotësuese të bimëve;		• Të mbikëqyrë plehërimin plotësues të bimëve sipas teknologjisë përkatëse.
	<b><u>Detyra 12</u></b> Mbikëqyr plehërimin plotësues të bimëve	• Llojet e krasitjeve në drufrutorë, krasitjet formuese dhe krasitjet prodhuese, mjetet dhe pajisjet përkatëse;		• Të mbikëqyrë punimet plotësuese për shërbimin e bimëve sipas teknologjisë së kulturave.
	<b><u>Detyra 13</u></b> Mbikëqyr punimet plotësuese për shërbimin e bimëve sipas teknologjisë së kulturave	• Llojet e sëmundjeve dhe dëmtuesve të kulturave bujqësore; • Llojet e pesticideve dhe herbicideve që përdoren në bujqësi;		• Të mbikëqyrë krasitjet në kulturat drufrutore, vreshta, ullishte dhe agrume sipas kalendarit vjetor dhe teknikave përkatëse.
	<b><u>Detyra 14</u></b> Mbikëqyr krasitjet në kulturat drufrutore, vreshta, ullishte dhe agrume sipas kalendarit vjetor	• Protokollet e trajtimeve të mbrojtjes së bimëve sipas kalendarëve vjetorë; • Pjekjen teknike, pjekjen për konsum dhe pjekjen për treg të kulturave të ndryshme		• Të mbikëqyrë trajtimet fitosanitare të mbrojtjes së bimëve sipas protokollit dhe kalendarit vjetor.
	<b><u>Detyra 15</u></b>			• Të mbikëqyrë procesin e pjekjes së kulturave bujqësore sipas

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
	Mbikëqyr trajtimet fitosanitare të bimëve sipas kalendarit vjetor	bujqësore; • Parashikimi i vjeljeve dhe kriteret fizike, kimike e metabolike të vjeljes; • Teknikat dhe mjetet e punës për korrjen dhe kositje të bimëve të arave; • Teknikat e trajtimit të produkteve pas vjeljes, • Metodat e ruajtjes së produkteve në magazinë dhe pikat e grumbullimit.		destinacionit, • Të mbikëqyrë procedurën e vjeljes së kulturave frutore sipas teknikave përkatëse. • Të mbikëqyrë procedurën e korrjes dhe kositjes së bimëve të arave sipas teknikave përkatëse. • Të mbikëqyrë grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit bujqësor në magazina dhe pikat e grumbullimit sipas llojit të bimëve dhe metodave përkatëse të ruajtjes.
	<b><u>Detyra 16</u></b> Mbikëqyr procesin e pjekjes së kulturave bujqësore			
	<b><u>Detyra 17</u></b> Mbikëqyr procedurën e vjeljes së bimëve frutore			
	<b><u>Detyra 18</u></b> Mbikëqyr procedurën e korrjes së bimëve të arave			
	<b><u>Detyra 19</u></b> Mbikëqyr grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit bujqësor në magazina dhe pikat e grumbullimit			
<b><u>Funksioni</u></b> <b><u>4</u></b> Mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë së prodhimit bimor	<b><u>Detyra 1</u></b> Vlerëson cilësinë biologjike të tokës	• Ligjin Shqiptar për bujqësinë BIO (Ligji nr. 106/2016 “Për prodhimin biologjik, etiketimin e produkteve biologjike dhe kontrollin e tyre”) dhe (Regulation (EU) 2018/848 “On organic production and labelling of organic products”); • Metodat dhe teknikat e analizimit të cilësive biologjike të tokës; • Metodat e ruajtjes së biodiversitetit dhe cilësive të tokës	• Korrekt/e • I/e • Bashkëpunues/e • Kreativ/e • I/e komunikues/hem/e • I/e duruar	• Të vlerësojë cilësinë biologjike të tokës sipas teknikave përkatëse. • Të mbikëqyrë përgatitjen e tokës duke ruajtur mjedisin mikrobiologjik të saj sipas teknikave përkatëse. • Të përzgjedhë fara dhe/apo fidanë me prejardhje organike sipas certifikatës së origjinës. • Të mbikëqyrë plehërimin organik të tokës sipas teknikave të kompostimit.
	<b><u>Detyra 2</u></b> Mbikëqyr përgatitjen e tokës duke ruajtur mjedisin mikrobiologjik të saj			
	<b><u>Detyra 3</u></b> Përzgjedh fara dhe/apo fidanë me prejardhje organike			
	<b><u>Detyra 4</u></b> Mbikëqyr plehërimin organik të tokës			
	<b><u>Detyra 5</u></b>			



**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
biologjik (BIO)	Mbikëqyr mbjelljen e farave dhe fidanëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Treguesit e biodiversitetit në fermë;</li> <li>• Tipet e punimeve të tokës dhe teknikat e punimeve minimale;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fleksibël/e</li> <li>• I/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë mbjelljen e farave dhe fidanëve sipas teknikave përkatëse.</li> <li>• Të mbikëqyrë zbatimin e shërbimeve agroteknike sipas parametrave të kultivimit të prodhimit BIO.</li> <li>• Të mbikëqyrë proceset e korrjes, kositjes dhe vjeljes së kulturave bujqësore BIO sipas teknikave përkatëse.</li> <li>• Të zbatojë hallkat teknologjike për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO, sipas standardeve dhe kërkesave ligjore.</li> <li>• Të zbatojë normat teknike të mbarështimit dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe shpendëve sipas standardeve dhe kërkesave ligjore.</li> <li>• Të mbikëqyrë normat teknike të prodhimeve blegtorale BIO, sipas standardeve dhe kërkesave ligjore.</li> <li>• Të mbikëqyrë kushtet e ruajtjes së prodhimit BIO sipas parametrave të kërkuar.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 6</u></b> Mbikëqyr zbatimin e shërbimeve agroteknike sipas parametrave të kultivimit të prodhimit BIO	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Normat teknike për prodhimin bujqësor BIO;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• vëmendshëm/me</li> </ul>	
	<b><u>Detyra 7</u></b> Mbikëqyr proceset e korrjes/vjeljes së kulturave bujqësore BIO	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e prodhimit të farave dhe fidanëve në bujqësinë BIO,</li> <li>• Llojet e plehrave, metodat dhe teknikat e plehërimit organik në bujqësinë BIO;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vigjilent/e</li> <li>• I/e</li> </ul>	
	<b><u>Detyra 8</u></b> Mbikëqyr hallkat teknologjike për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e administrimit të pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë BIO;</li> <li>• Teknikat e prodhimit të farave e fidanëve në bujqësinë BIO;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• qëndrueshëm/me</li> <li>• I/e</li> </ul>	
	<b><u>Detyra 9</u></b> Mbikëqyr normat teknike të mbarështimit dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe shpendëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodatat e administrimit të pjellorisë natyrore të tokës në bujqësinë BIO;</li> <li>• Teknikat e prodhimit të farave e fidanëve në bujqësinë BIO;</li> <li>• Teknikat e mbjelljes së farave dhe fidanëve në bujqësinë BIO;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• moralshëm/me</li> </ul>	
	<b><u>Detyra 10</u></b> Mbikëqyr normat teknike të prodhimeve blegtorale BIO	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Normat teknike të shërbimeve agroteknike në bujqësinë BIO;</li> <li>• Preparatet e lejuara për plehërimin dhe mbrojtjen e bimëve në bujqësinë BIO;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 11</u></b> Mbikëqyr kushtet e ruajtjes së prodhimit BIO	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknikat e korrjes, kositjes dhe vjeljes në bujqësinë BIO;</li> <li>• Parametrat teknologjikë për prodhimin e ushqimit blegtoral BIO;</li> <li>• Kushtet teknike të mbarështimit dhe kujdesit shëndetësor të kafshëve dhe</li> </ul>		

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
		shpendëve për prodhime BIO; • Normat teknike për prodhimet blegtorale BIO; • Teknikat e trajtimit dhe metodat e ruajtjes së produkteve pas vjeljes në bujqësinë BIO, në magazinë dhe pikat e grumbullimit, • Normat teknike të kontrollit, certifikimit dhe etiketimit në bujqësinë BIO; • Logot e prodhimit BIO dhe rëndësia e tyre; • Treguesit e cilësisë së prodhimeve BIO; • Marketingu dhe kanalet e tregtimit në bujqësinë BIO.		
<b>Funksioni</b> <b>5</b> Mbikëqyr dhe zbaton hallkat e teknologjisë së	<b>Detyra 1</b> Mbikëqyr përzgjedhjen e kafshëve të nevojshme për mbarështim	• Llojet e kafshëve, rëndësia dhe prejdardhja e kafshëve shtëpiake; • Higjiena e përgjithshme e tufës dhe e fermës; • Higjiena e ujit dhe enëve të tij, baseneve apo të tjera ujë-pirëse; • Rëndësia e higjienës së vendqëndrimit dhe procedurat e pastrimit të tij; • Morfologjia dhe fiziologjia e kafshëve;	• Korrekt/e • I/e singertë • Bashkëpunues/e • Kreativ/e • I/e komunikueshëm/me • I/e duruar	• Të mbikëqyrë përzgjedhjen e kafshëve të nevojshme për mbarështim sipas drejtimit ekonomik. • Të mbikëqyrë kontrollin e higjienës së mjedisit brenda dhe jashtë fermës sipas standardeve të kërkuara. • Të mbikëqyrë riprodhimin e tufës sipas kalendarit vjetor. • Të vrojtojë dhe raportojë sjelljen dhe gjendjen shëndetësore të kafshës.
	<b>Detyra 2</b> Mbikëqyr kontrollin e higjienës së mjedisit brenda dhe jashtë fermës			
	<b>Detyra 3</b> Mbikëqyr riprodhimin e tufës			
	<b>Detyra 4</b> Vrojton dhe raporton sjelljen dhe gjendjen shëndetësore të kafshës			

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
prodhimit blegtoral	<b><u>Detyra 5</u></b> Grupon dhe strehon kafshët sipas llojit, racës, gjinisë, moshës dhe gjendjes fiziologjike	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i aparatit të riprodhimit në kafshët bujqësore dhe shpendët;</li> <li>• Cikli seksual dhe ovulimi;</li> <li>• Shenjat e afshit në kafshët bujqësore;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Fleksibël/e</li> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> <li>• Vigjilent/e</li> <li>• I/e qëndrueshëm/me</li> <li>• I/e moralshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të grupojë dhe strehojë kafshët sipas llojit, racës, gjinisë, moshës dhe gjendjes fiziologjike.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e të ushqyerit të gjedhëve sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e të ushqyerit të imtave (të leshta dhe të dhirta) sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e të ushqyerit të derrit sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e të ushqyerit të një thundrak sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës.</li> <li>• Të zbatojë teknikat e të ushqyerit të shpendëve sipas nevojave dhe drejtimit ekonomik të fermës.</li> <li>• Të kontrollojë higjienën e ushqimeve sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve.</li> <li>• Të kontrollojë higjienën e mjeteve dhe impianteve të ujit dhe të ushqimit sipas standardeve të kërkuara.</li> <li>• Të kujdeset për të ushqyerit e të</li> </ul>
	<b><u>Detyra 6</u></b> Zbaton teknikat e të ushqyerit të gjedhëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Treguesit normalë jetësorë të kafshëve;</li> <li>• Etologjia e kafshëve;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 7</u></b> Zbaton teknikat e të ushqyerit të imtave (të leshta dhe të dhirta)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e strehimit dhe mikroklimës në stallë sipas llojit të kafshës, kategorisë, gjinisë dhe gjendjes fiziologjike;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 8</u></b> Zbaton teknikat e të ushqyerit të derrit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e ushqimeve, karakteristikat dhe përdorimi i tyre;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 9</u></b> Zbaton teknikat e të ushqyerit të një thundrak	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e lopëve në periudhën e laktacionit, barsmërisë dhe të tharjes;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 10</u></b> Zbaton teknikat e të ushqyerit të shpendëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e mëshqerrave dhe viçave për majmëri;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e demave për ndërzim;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 11</u></b> Kontrollon higjienën e ushqimeve voluminoze dhe të koncentruara sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit intensiv dhe ekstensiv i dosave në periudhën e laktacionit, barsmërisë dhe në tharje;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 12</u></b> Kontrollon higjienën e mjeteve dhe impianteve të ujit dhe të ushqimit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e gicave në shkëputje;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 13</u></b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit intensiv dhe ekstensiv i derrave në majmëri;</li> </ul>		

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
	Kujdeset për të ushqyerit e të porsalindurve	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e harcit për ndërzim;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e njëthundrakëve (kuaj, gomerë, mushka;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e deleve gjatë ndërzimit, barsmërisë, laticionit;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e qengjave;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e deshve gjate ndërzimit;</li> <li>• Inkubimi (artificial dhe natyral) i vezëve;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit të shpendëve për vezë dhe për mish;</li> <li>• Mënyrat e parandalimit të kontaminimit të ushqimeve të kafshëve;</li> <li>• Mënyrat e të ushqyerit e të porsalindurve;</li> <li>• Rëndësia e përshtatjes së të ushqyerit në raste patologjike;</li> <li>• Kalendari i masave profilaktike;</li> <li>• Higjiena personale e punonjësit përgjegjës të mjeljes;</li> <li>• Llojet e detergjenteve, desinfektantëve dhe të pastruesve të lejuar për enët, makinat mjelëse apo sipërfaqe të tjera dhe përdorimet e tyre;</li> <li>• Procedurat e pastrimit të impianteve</li> </ul>		<p>porsalindurve sipas kërkesave teknike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë të ushqyerit e kafshës pas lindjes sipas nevojave.</li> <li>• Të kujdeset për të ushqyerit e kafshës me patologji sipas nevojave dhe gjendjes shëndetësore.</li> <li>• Të zbatojë kalendarin e masave të përgjithshme profilaktike sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve.</li> <li>• Të mbikëqyrë zbatimin e masave higjienike gjatë mjeljes sipas standardeve të kërkuara.</li> <li>• Të mbikëqyrë grumbullimin dhe seleksionimin e vezëve sipas cilësisë.</li> <li>• Të mbikëqyrë grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit blegtoral.</li> <li>• Të mbikëqyrë zbatimin e masave për administrimin e mbetjeve të fermës bujqësore dhe blegtorale sipas kërkesave teknike përkatëse.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 14</u></b> Mbikëqyr të ushqyerit e kafshës pas lindjes			
	<b><u>Detyra 15</u></b> Kujdeset për të ushqyerit e kafshës me patologji			
	<b><u>Detyra 16</u></b> Zbaton kalendarin e masave të përgjithshme profilaktike sipas llojit dhe kategorisë së kafshëve			
	<b><u>Detyra 17</u></b> Mbikëqyr zbatimin e masave higjienike gjatë mjeljes, transportit dhe ruajtjes së qumështit			
	<b><u>Detyra 18</u></b> Mbikëqyr grumbullimin dhe seleksionimin e vezëve			
	<b><u>Detyra 19</u></b> Mbikëqyr grumbullimin dhe ruajtjen e prodhimit blegtoral			
	<b><u>Detyra20</u></b> Mbikëqyr zbatimin e masave për administrimin e mbetjeve			

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
		mjelës, enëve apo pajisjeve të qumështit; <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologjia e grumbullimit dhe ruajtja e prodhimeve blegtorale;</li> <li>• Mënyrat e përpunimit të plehut organik;</li> <li>• Mënyrat e asgjësimit të mbetjeve shtazore dhe bimore.</li> </ul>		
<b>Funksioni</b> <b><u>6</u></b>  Përdor dhe mirëmban makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punimet bazë dhe plotësuese	<b><u>Detyra 1</u></b> Përzgjedh makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punimet bazë dhe plotësuese	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e mjeteve bujqësore, agregateve, pajisjeve dhe veglave të punës, funksionimi dhe përdorimi i tyre;</li> <li>• Proceset e punës që kryhen me mjete bujqësore dhe agregatet e tyre;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrekt /e</li> <li>• I/e sinqertë</li> <li>• Bashkëpunues/e</li> <li>• Kreativ/e</li> <li>• I/e komunikueshëm/me</li> <li>• I/e duruar</li> <li>• Fleksibël/e</li> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> <li>• Vigjilent/e</li> <li>• I/e qëndruesh</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përzgjedhë makineritë, pajisjet dhe veglat e punës për punimet bazë dhe plotësuese sipas proceseve të punës.</li> <li>• Të mbikëqyrë kontrollin e gjendjes së makinerive, mjeteve dhe agregateve të tyre, si dhe gatishmërinë e tyre sipas manualeve përkatëse.</li> <li>• Të mbikëqyrë pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, mjeteve dhe agregateve bujqësore sipas manualeve përkatëse.</li> <li>• Të mbikëqyrë pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve blegtorale sipas manualeve përkatëse.</li> <li>• Të mbikëqyrë riparime të thjeshta të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 2</u></b> Mbikëqyr kontrollin e gjendjes së makinerive, mjeteve dhe agregateve, si dhe gatishmërinë e tyre	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e kontrollit të gjendjes së makinerive, mjeteve dhe pajisjeve;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 3</u></b> Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, mjeteve dhe agregateve bujqësore	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e pastrimit të mjeteve, makinerive dhe agregateve bujqësore;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 4</u></b> Mbikëqyr pastrimin dhe mirëmbajtjen e makinerive dhe pajisjeve blegtorale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e mirëmbajtjes së mjeteve, makinerive, dhe agregateve bujqësore;</li> </ul>		
	<b><u>Detyra 5</u></b> Mbikëqyr riparime të thjeshta të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e pastrimit të makinerive dhe pajisjeve blegtorale;</li> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e mirëmbajtjes së makinerive dhe pajisjeve blegtorale;</li> </ul>		

**Teknik i mesëm në bujqësi**

Funksionet	Përgjegjësitë /Detyrat	Njohuritë	Qëndrimet	Kriteret e performancës
dhe blegtorale	<p align="center"><b><u>Detyra 6</u></b></p> <p>Kryen kolaudimin dhe regjistrimin e agregateve sipas proceseve të punës</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat dhe mjetet e punës për riparimin e thjeshtë të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;</li> <li>• Kalendari i shërbimeve të makinerive dhe pajisjeve bujqësore dhe blegtorale;</li> <li>• Rëndësia dhe mënyrat e regjistrimit të agregateve;</li> <li>• Mjetet bujqësore dhe agregatet për sistemimet dhe punimet e tokave;</li> <li>• Mjetet dhe agregatet për mbjelljen e dhe në shërbimet e bimëve (plehërime, ujitje, trajtime antiparazitare etj.);</li> <li>• Mjetet bujqësore dhe agregatet për korrjen, kositjen dhe vjeljen e produkteve bujqësore;</li> <li>• Mjetet bujqësore dhe agregatet për përpunimin dhe ruajtjen e prodhimeve bujqësore;</li> <li>• Mjetet bujqësore për mbarështimin blegtoral;</li> <li>• Teknikat e seleksionimit dhe standardizimit të prodhimeve bujqësore.</li> </ul>	<p>ëm/me</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e</li> </ul> <p>moralshë m/me</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kryejë kolaudimin dhe regjistrimin e agregatëve sipas proceseve të punës dhe manualeve përkatëse.</li> </ul>
	<p align="center"><b><u>Detyra 1</u></b></p> <p>Mbikëqyr pastrimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale nga</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat dhe teknikat e pastrimit të produkteve bujqësore dhe blegtorale,</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Korrekt/e</li> <li>• I/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë pastrimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale nga</li> </ul>

**Teknik i mesëm në bujqësi**

<b>Funksionet</b>	<b>Përgjegjësitë /Detyrat</b>	<b>Njohuritë</b>	<b>Qëndrimet</b>	<b>Kriteret e performancës</b>
<p><b><u>Funksioni</u></b> <b><u>7</u></b></p> <p>Kryen proceset e përpunimit të thjeshtë të prodhimit bujqësore dhe blegtoral</p>	papastërtitë dhe lëndët e huaja	mjetet dhe materialet përkatëse;	sinqertë	papastërtitë dhe lëndët e huaja sipas teknikave përkatëse.
	<b><u>Detyra 2</u></b> Ambalazhon dhe etiketon produktet bujqësore dhe blegtorale për treg	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mënyrat e parapërgatitjes së lëndëve të para për përpunime të thjeshta;</li> <li>• Teknikat e përpunimit artizanal të produkteve bujqësore dhe blegtorale;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkëpunues/e</li> <li>• Kreativ/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përgatitë lëndët e para për përpunime të thjeshta sipas llojit të produktit dhe metodave përkatëse.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 3</u></b> Përgatit lëndët e para për përpunime të thjeshta	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vetitë organoleptike të qumështit dhe rëndësia e kontrollit të tyre;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e komunikueshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë përpunimin artizanal të produkteve bujqësore (reçel, komposto, fruta të thata, çarja, raki, etj.) sipas teknikave përkatëse.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 4</u></b> Mbikëqyr përpunimin artizanal të produkteve bujqësore (reçel, komposto, fruta të thata, çarja, raki, etj.)	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metodat dhe mjetet e punës për sterilizimin dhe pasterizimin e qumështit;</li> <li>• Teknikat e përpunimit të qumështit dhe llojet e nënprodukteve të tij;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e duruar</li> <li>• Fleksibël/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kontrollojë vetitë organoleptike të qumështit sipas parametrave të kërkuara.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 5</u></b> Kontrollon vetitë organoleptike të qumështit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e konservantëve për përpunime të thjeshta dhe përdorimet e tyre;</li> <li>• Metodat e seleksionimit të vezëve;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e vëmendshëm/me</li> <li>• Vigjilent/e</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë sterilizimin dhe pasterizimin e qumështit sipas teknikave dhe parametrave të kërkuara.</li> </ul>
	<b><u>Detyra 6</u></b> Mbikëqyr sterilizimin dhe pasterizimin e qumështit	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknikat e ruajtjes në magazinë të prodhimeve bujqësore duke ruajtur parametrat e temperaturës dhe lagështisë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• I/e qëndrueshëm/me</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbikëqyrë përpunimin e qumështit në nënprodukte të tij sipas parametrave të kërkuara.</li> </ul>
